



Teksti zyrtar siç është amendamentuar me 11.11.2010

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,

Në bazë të nenit 54, 55, 58 dhe nenit 64.2 pika (a) dhe (b) të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, si dhe nenit 19 dhe 20 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës nxjerr:

RREGULLËN ZGJEDHORE Nr. 07/2009 VËZHguesIT E ZGJEDHJEVE

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Organizatë" do të thotë një subjekt i certifikuar politik, OJQ, organizatë qeveritare ose ndërqeveritare, organizatë ndërkombëtare e specializuar dhe e përfshirë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfaqësuesit e vendeve të huaja dhe media.

1.2 "Organizatë e akredituar" do të thotë organizatë që është akredituar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për të vëzhguar procesin e zgjedhjeve.;

1.3 "Vëzhgues i akredituar" do të thotë përfaqësuesi i një subjekti të certifikuar politik, OJQ-je, organizate qeveritare ose ndërqeveritare, organizate ndërkombëtare të specializuar dhe të përfshirë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, vendi të huaj, media ose ndonjë individ që vëzhgon në emër të një organizate, i certifikuar nga KQZ-ja për të vëzhguar procesin e zgjedhjeve.

Neni 2 Dispozitat e përgjithshme

2.1 Procesi i akreditimit të organizatave dhe të individëve në emër të organizatave për vëzhgimin e zgjedhjeve do të bëhet në përputhje me kriteret dhe parimet e përcaktuara në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës dhe në këtë rregull të zgjedhjeve.

2.2 Individët në emër të organizatave dhe organizatat që parashetrojnë kërkesë për akreditim për të vëzhguar procesin e zgjedhjeve, si dhe të nominuarit e tyre për vëzhgues duhet t'i përmbushin të gjitha kriteret e zotësisë juridike të përcaktuara në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës dhe në këtë rregull të zgjedhjeve.

2.3 Vëzhguesit dhe organizatat e akredituara që vëzhgojnë procesin e zgjedhjeve dhe/ose ditën e zgjedhjeve, konsiderohet se kanë njohuri për të drejtat dhe obligimet e tyre të përcaktuara nga ligjet e aplikueshme për procesin e zgjedhjeve, përfshirë edhe rregullat e zgjedhjeve.

Neni 3
Akreditimi i organizatave dhe i vëzhguesve të tyre

3.1 Organizatat që aplikojnë për akreditim për vëzhgimin e zgjedhjeve duhet të dorëzojnë kërkesë në KQZ-së (Zyrë), jo më vonë se njëzet e pesë (25) ditë para ditës së Zgjedhjeve.

3.2 Organizatat që aplikojnë për akreditim për vëzhgimin e Ditës së Zgjedhjeve duhet të dorëzojnë kërkesën në KQZ (Zyrë), jo më vonë se njëzet (20) ditë para ditës së Zgjedhjeve.

3.3 Organizatat që aplikojnë duhet të plotësojnë dokumentacionin si në vijim:

(a) formularin e akreditimit të vëzhguesit, që është i bashkangjitur këtu si Shtojca 1;

(b) listën e vëzhguesve në formën e bashkangjitur këtu si Shtojca 2 që përmban: emrin, mbiemrin, datën e lindjes, adresën, numrin personal dhe numrin e telefonit për kontaktim për secilin vëzhgues në formën elektronike dhe kopje të shtypur të nënshkruar nga përfaqësuesi i organizatës; dhe

(c) deklaratën e vëzhguesit në formën e bashkangjitur këtu si Shtojca 3, të nënshkruar nga secili vëzhgues i përfshirë në listën e vëzhguesve me të cilën vërtetohet se ai ose ajo:

- i përmbush kriteret e zotësisë juridike për të qenë vëzhgues; dhe
- është i gatshëm të jetë vëzhgues i asaj organizate; dhe
- do t'i përmbahet Kodit të Sjelljes për Vëzhgues.

3.4 Individët duhet të dorëzojnë kërkesën e tyre për akreditim për vëzhgim të zgjedhjeve në emër të organizatës në KQZ (Zyrë), jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para Ditës së Zgjedhjeve.

3.5 Individët në emër të organizatës, të cilët mendojnë të aplikojnë për vëzhgim, duhet të plotësojnë dokumentacionin ashtu siç është përcaktuar në nenin 3.3 të kësaj rregulle të zgjedhjeve:

(a) Formularin për akreditim të vëzhguesit;

(b) Emrin, mbiemrin, datën e lindjes, adresën, numrin personal dhe numrin e telefonit për kontaktim të individit në formën elektronike dhe kopje të shtypur të nënshkruar nga përfaqësuesi i organizatës në emër të së cilës individi mendon të vëzhgojë; dhe

(c) deklaratën e vëzhguesit në formën e bashkangjitur këtu si Shtojca 3, të nënshkruar nga secili vëzhgues i përfshirë në listën e vëzhguesve me të cilën vërtetohet se ai ose ajo:

- i përmbush kriteret e zotësisë juridike për të qenë vëzhgues; dhe
- është i gatshëm të jetë vëzhgues në emër të asaj organizate; dhe
- do t'i përmbahet Kodit të Sjelljes për Vëzhgues.

3.6 Sekretariati i KQZ-së (Zyra) duhet t'i verifikojë dokumentet e dorëzuara nga organizata apo individët në emër të organizatës për akreditim, sipas nenit 3.4 dhe 3.5 të kësaj Rregulle; dhe ose:

(a) i dorëzon ato në KQZ me rekomandimin për akreditim, jo më vonë se katër (4) ditë pas parashtrimit të tyre, nëse dokumentet janë të plota dhe të nënshkuara si duhet; ose

(b) brenda të njëjtit afat ia kthen dokumentet aplikuesit për korrigjim, nëse konstaton se kërkesa për akreditim nuk është e plotë ose është e pasaktë, me njoftimin se çka duhet të plotësohet ose të korrigjohet.

3.7 Organizata apo individët në emër të organizatës, dokumentet për akreditim të dorëzuara të së cilës janë kthyer si jo të plota ose të pasakta si në nenin 3.6 (b) të kësaj Rregulle, duhet t'i bëjë korrigjimet e vëna në dukje dhe plotësimet në kërkesë dhe t'i ridorëzojë ato dokumente në Zyra brenda tri (3) ditëve nga njoftimi.

3.8 Brenda tri (3) ditëve nga marrja e rekomandimit për akreditim nga Zyra, KQZ-ja duhet të vendosë që ose:

(a) ta akreditojë organizatën dhe t'ia certifikojë listën e saj të vëzhguesve, apo të akreditojë dhe të certifikojë individin në emër të një organizate; ose

(b) t'ia refuzojë kërkesën për akreditim dhe ta njoftojë me shkrim organizatën përkatëse apo individin përkatës në emër të një organizate, duke i dhënë shpjegime për vendimin e vet dhe duke e informuar parashtruesin e kërkesës për të drejtën e ankimit ndaj atij vendimi në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP).

3.9 Kërkesa duhet të aprovohet ose të refuzohet jo më vonë se dhjetë (10) ditë pas dorëzimit dhe pranimit të dokumentacionit të plotë dhe të plotësuar.

3.10 Zyra duhet ta njoftojë organizatën ose individin në emër të një organizate se KQZ-ja e ka akredituar atë, dhe se i ka certifikuar vëzhguesit e saj dhe t'ia sigurojë organizatës së akredituar apo individit të akredituar në emër të një organizate, letrën e akreditimit dhe distinktivët e veçantë për të gjithë vëzhguesit.

Neni 4

Obligimet e organizatave të akredituara dhe të vëzhguesve të tyre, apo individëve që vëzhgojnë në emër të një organizate

4.1 Secila organizatë e akredituar apo individ që vëzhgon në emër të një organizate, duhet t'i marrë distinktivët për vëzhguesit e vet brenda afatit prej tri (3) ditëve të punës prej ditës së njoftimit me shkrim për akreditim nga Zyra.

4.2 Organizata e akredituar është përgjegjëse për shpërndarjen e distinktivëve vëzhguesve të vet veç e veç, pas verifikimit të identitetit të tyre. Organizata duhet të mbajë dosjen e secilës deklaratë të nënshkruar të vëzhguesit, emrat dhe të dhënat për kontaktim të vëzhguesve të vet.

4.3 KQZ-ja mund ta anulojë akreditimin e vëzhguesit të procesit zgjedhor që i ka cënuar ligjet në fuqi, rregullat e zgjedhjeve, urdhëresat administrative ose procedurat administrative lidhur me procesin zgjedhor.

4.4 Organizata e akredituar është përgjegjëse për sjelljen individuale të vëzhguesve të saj. Nëse organizata e akredituar konstaton se ndonjëri nga vëzhguesit e saj, apo një individ që vëzhgon në emër të një organizate ka shkelur Kodin e Sjelljes për Vëzhgues, ajo mund ta anulojë distinktivin e atij vëzhguesi dhe t'ia dorëzojë atë KQZ-së në mënyrë që atij ose asaj t'i anulohet akreditimi si vëzhgues.

4.5 Pa marrë parasysh dispozitat e nenit 3.8 (a) të kësaj Rregulle, KQZ-ja ose PZAP-i mund që po ashtu, me vetë iniciativë ose pas njoftimit nga Zyra ose cildo nga ZKZ-të, t'ia anulojnë akreditimin cilitdo vëzhgues që nuk e respekton Kodin e Sjelljes për Vëzhguesit ose që në çfarëdo mënyre e pengon procesin e zgjedhjeve. Në rast të sjelljes së keqe të përsëritur ose të rëndë nga ana e një ose më shumë vëzhguesve nga e njëjta organizatë e akredituar, KQZ-ja ose PZAP-i mund të vendosin të anulojnë menjëherë akreditimin e organizatës së akredituar. Një vendim i tillë e anulon automatikisht akreditimin e të gjithë vëzhguesve të asaj organizate të akredituar.

4.6 Vëzhguesi duhet ta njoftojë me shkrim organizatën e akredituar të tij/saj për çdo ngjarje të konstatuar gjatë vëzhgimit të procesit të zgjedhjeve, ose për çdo ankesë që ai/ajo ka dorëzuar te cilido prej organeve të zgjedhjeve, duke i cekur rrethanat dhe kohën kur ka ndodhur ngjarja e tillë.

4.7 Organizata e akredituar apo një individ që vëzhgon në emër të një organizate, mund të parashtrijë ankesë pranë KQZ-së nëse ai/ajo nuk ka qasje në të gjitha takimet dhe dokumentet e KKZ-së. KQZ-ja do të marrë vendim në lidhje me ankesën brenda 48 orëve dhe do të ndërmarrë veprime të cilat i konsideron të duhura.

4.8 Organizata e akredituar apo individ që vëzhgon në emër të një organizate mund të parashtrijë ankesë pranë KQZ-së, ZKZ-së, Sekretariatit të KQZ-së, apo PZAP-it për çdo parregullsi tjetër, shkelje të procedurave ose incidente të dëshmuara gjatë vëzhgimit të procesit të zgjedhjeve. Ankesat në PZAP do të parashtrihen në pajtim me Rregullat e Procedurës së PZAP-it. Ankesat pranë KQZ-së, ZKZ-së apo Sekretariatit të KQZ-së duhet të bëhen brenda afatit prej (24) orësh. Në ankesën e tillë duhet të përfshihen përshkrimi i fakteve, vendi dhe koha e ngjarjes, dhe gjithashtu emri i vëzhguesit të pranishëm dhe numri i tij/saj i distinktivit.

Neni 5
Hyrja në fuqi

Kjo Rregull e ndryshuar zëvendëson Rregullën e mëparshme për Vëzhguesit e Zgjedhjeve dhe hyn në fuqi më 25.06.2009.

Nesrin Lushta

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
